



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 321, Datë 14.11.2023**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GERTI” SH.P.K, NË  
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
HIDROCENTRALI “MIRESHI” ME FUQI TË INSTALUAR 1.900 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2360/1 prot., datë 10.11.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Mireshi” me fuqi të instaluar 1.900MW, me vendndodhje në përroin e Mireshit, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 1.900MW”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “GERTI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2360 prot., datë 02.11.2023 paraqiti aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentrali “Mireshi”, me vendndodhje në përroin e Mireshit, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 1.900 MW.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni

9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).

- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit, e cila sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, nuk është e plotë. **Shoqëria në vijim të kryej pjesën e mbetur të pagesës për aplikimin për paisje me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, para se ERE të shprehet me vendim përfundimtar.**
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “GERTI” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a” dhe “c” si dhe për pikën 2, gërmat “a”, “b”, “d”, “e” dhe “f”.
- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni si vijon:

## **NENI 9**

### **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

#### **Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë**

*Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të depozitojë vërtetimin e gjëndjes gjyqësore nga Drejtoria e Burgjeve për shoqërinë “GERTI” sh.p.k.

*Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- **gërma “b”**: Shoqëria ka bërë me dije se ka përfunduar plotësisht ndërtimin e veprës, në kuadër të kërkesave të kësaj pike të rregullores, shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion mbi mënyrën e financimit të ndërtimit të tij me fonde të vetat, apo financim nga të tretë (kredi bankare etj).

#### **Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës.**

- **gërma “c”**: Shoqëria ka depozituar në ERE miratimin e pikës së lidhjes nga OSSH sh.a. për një kapacitet të ndryshëm nga ai i miratuar në kontratën me MIE-n, si e tillë shoqëria në vijim të depozitojë në ERE informacion në lidhje me arsyen e këtij miratimi, kapaciteti i cili rezulton të jetë i ndryshëm nga ai i kontratës me autoritetin kontraktor.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Mireshi”, me vendndodhje në përroin e Mireshit, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 1.900 MW, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**